



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

Tiranë, më 20.12.2018

*Dokument parlamentar*

## R A P O R T

### **PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR.11015, DATË 20.12.2018, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 94/2018 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 20 dhjetor 2018, shqyrtoi Dekretin e Presidentit të Republikës nr.11015, datë 20.12.2018, “Për kthimin e ligjit nr. 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat caktoi relator për shqyrtimin e këtij dekreti, z. Ervin Bushati.

Në mbledhjen e komisionit për të dhënë vlerësimin mbi Dekretin e Presidentit ishte i pranishëm Ministri i Financave dhe Ekonomisë Z. Arben Ahmetaj.

Presidenti i Republikës bazuar në nenin 85, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka depozituar pranë Kuvendit, Dekretin nr. nr.11015, datë 20.12.2018, “Për kthimin e ligjit nr. 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.” Bazuar në nenin 27, pika 7, të Rregullores së Kuvendit, ky Dekret, është futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, me cilësinë e komisionin përgjegjës, bazuar në nenit 86, dhe 32-38 të Rregullores së Kuvendit, e merr në shqyrtim këtë Dekret vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës, pra konkretisht shqyrton vetëm çështjet e ngritura lidhur me nenet 9 dhe 11, të ligjit nr. 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.”

Presidenti i Republikës në arsyetimin e tij për kthimin e ligjit, është mbështetur kryesisht në elementët e më poshtëm:

- Dispozita e nenit 9, e cila propozon lehtësimin e barrës fiskale, nëpërmjet uljes së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, edhe për fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më

parë, bie në kundërshtim me parimin e kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe krijon pasiguri juridike për aplikimin e tij në praktikë.

- Dispozita e sipërcituar është në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenit 155, të Kushtetutës, i cili ndalon trajtimin fiskal preferencial me efekt prapaveprues.
- Dispozita e nenit 11, për hyrjen në fuqi të ligjit me datë 1 janar 2019, bie ndesh me parashikimet e nenit 84, pika 3, të Kushtetutës përsa i takon afatit të hyrjes në fuqi të ligjit. Neni 84, pika 3 e Kushtetutës dikton detyrimin që ligji duhet të hyjë në fuqi jo më parë se 15 ditë nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

Gjatë diskutimeve në mbledhje si nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë ashtu dhe nga anëtarët e Komisionit Dekreti i propozuar nga Presidenti i Republikës për rishqyrtimin e ligjit nr. 94/2008, u koniderua si politik, jo i drejtë dhe si i tillë nuk mund të miratohej, duke paraqitur argumentat kundërshtues si vijon:

- Nisma ligjore për të ndryshuar normën e tatimit të dividendit nga 15% në 8%, u ndërmorr si një iniciativë, e cila jo vetëm do ulë ngarkesën fiskale të investitorëve të kapitalit, por do nxisë njëkohësisht shtimin e konsumit çka do stimulojë prodhimin dhe importet. Parimi i sigurisë juridike, kërkon së pari, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, dhe së dyti, *vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë, në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi (Vendimi nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ndryshimi i propozuar nuk çënon parimin e sigurisë juridike, por qëllimi i këtij propozimi është nxitja e shpërndarjes së dividendit tek subjektet tregtare, si një kategori, e cila kontribuon në të ardhurat e buxhetit të shtetit, për t'i konvertuar më tej këto të ardhura në të mira dhe shërbime për të gjithë qytetarët.
- Propozimi për trajtim me të njëjtën normë tatimi edhe për subjektet, të cilat nuk kanë shpërndarë dividendin përpara vitit 2017, mbështetet në faktin se, referuar edhe ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme ka tagrin të vendosë, lidhur me destinimin e fitimit apo shpërndarjen e dividendit, jo vetëm një herë, por këtë të drejtë mund t'a ushtrojë sipas vullnetit të saj. Nisur sa më sipër, ky trajtim nuk mund të lidhet me një afat kohor të caktuar prekluziv. Në kushtet kur, afati i depozitimit të Vendimit të asamblesë lidhet me datën e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose hartimit të aktit të detyrueshëm, në këtë rast, me marrjen e Vendimit nga asambleja e përgjithshme, e cila lidhet me një vendimmarrje të prezumuar, pas hyrjes në fuqi të propozimeve, nuk kemi efekte prapavepruese.
- Dispozita ka rol sqarues për tatimpaguesit dhe administratën tatimore në mënyrë që të shmangen keqinterpretimet, keqkuptimet, dykuptimet, si dhe të sigurohet zbatimi i njëjtë dhe uniform i ligjit për të gjithë tatimpaguesit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësinë për abuzim me ligjin apo korrupsion. Kjo, pasi edhe sipas ligjit për shoqëritë tregtare, fitimi i pashpërndarë i cilitdo vit nuk është dividend, përveçse kur ka një vendim të asamblesë së shoqërisë për ta shpërndarë atë. Në këtë moment, ky fitim bëhet dividend dhe tatohet sipas tarifës që është në fuqi në momentin e pagesës. Ndryshimi i propozuar do të zbatohet në rastet kur, asambleja vendos përsëri të shpërndaje dividend, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke e lidhur me momentin e vendimmarrjes nga kjo assemble.

- Parashikimet e dispozitës 9, janë në analogji dhe me amendimet e mëparshme të këtij ligji, si në rastin kur u ndryshua norma e tatimit në burim nga 10% në 15%. Konkretisht, me ligjin nr. 156/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, u ndryshua norma e tatimit në burim për dividendin nga 10% në 15%, dhe nuk u përcaktua dhe as u pretendua të zbatohet në praktikë, që, fitimet e pashpërndara të viteve 2013 ose më parë të ttoheshin me 10%, në rast se vendimi i asamblesë mbi shpërndarjen e tyre do të merrej pas hyrjes në fuqi të ligjit të sipërcituar.

Për gjitha sa më sipër, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, vendosi mos miratimin e Dekretit nr. nr.11015, datë 20.12.2018, “Për kthimin e ligjit nr. 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

**RELATOR**

**KRYETARI**

**Ervin BUSHATI**

**Erjon BRAÇE**